




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 24 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 02/2013 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 05.03.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-4412/13, për znj. Sanije Gashi – Drejtor Departamenti për Informim Shëndetësor – Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për arsye se e njëjta ka shmangur situatën e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik, nr. AKK – 03-4412/13, për zyrtaren e lartë znj. Sanije Gashi – Drejtor Departamenti për Informim Shëndetësor në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës dhe njëkohësisht pronare në biznesin privat “Shkolla për Kompjuter Sa jeta”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në këtë rast, zyrtarja e lartë znj. Gashi, fillimisht është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit lidhur me funksionin e saj publik.

Pas pranimit të kësaj shkrese, zyrtarja në fjalë, është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë dhe i është sqaruar situata në të cilën ndodhet dhe me ndryshimet që duhet t'i bëj, për të shmangur situatën e mundshme të konfliktit të interesit. Në këtë takim ajo ka konfirmuar se në cilësinë e zyrtares së lartë ushtron funksionin e Drejtorit të Departamentit për Informim

Shëndetësor në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës dhe njëkohësisht është pronare në biznesin privat “Shkolla për Kompjuter Sa jeta”.

znj. Gashi ka kuptuar situatën e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, prandaj pas rekomandimit të Agjencisë, ka premtuar se do ta mbyll vullnetarisht biznesin privat.

Ndërkohë, znj. Gashi, ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI 03 – 753/14) në të cilën vërtetohet se e njëjta ka mbyllur biznesin.

Prandaj, duke pasur parasysh këto të dhëna, konstatohet se gjendja e mundshme e konfliktit të interesit është shmangur.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

